



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 40.2 nen c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.3/L-040, Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Nenit 6 dhe paragrafit 6 të nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023. Ligjit Nr. 08 /L-235 për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr.08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-213, Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal. Me kërkesën e Drejtorisë për Financa Ekonomi dhe Zhvillim si dhe me rekomandimet e KPF-së, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VI-të të rregullt të mbajtur më datën: 30.06.2023 , mori këtë :

V E N D I M

Për bartjen dhe shpërndarjen e mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake nga viti 2022 në vitin 2023

1. Miratohet vendimi për bartjen dhe shpërndarjen e mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2022 në vitin 2023 në shumë prej **346,194.57 €**.

1.1 Mjetet buxhetore si në pikë 1 të këtij vendimi, shuma prej **346,194.57** euro janë mjete të mbetura të pa shfrytëzuara nga të hyrat vetanake fondi (22) të vitit 2022 sipas planifikimit buxhetor.

2.. Shuma si në pikën 1 të këtij vendimi shpërndahet në programe dhe nen-programe buxhetore dhe në kategori ekonomike të shpenzimeve si në vijim:

- Mallra dhe Shërbime në shumën prej **6,000.00 €**;
- Shpenzimet komunale në shumën prej **3,374.57 €**;
- Shpenzime kapitale në shumën prej **336,820.00 €**.

2.1 Në kategorinë mallra dhe shërbime :

Administrata (16318), shuma prej 6,000.00 €.

- **Arsyetim:** Bartje e obligimeve të pashlyera si dhe shpenzimet e krijuara nga dëmet e shkaktuara nga vërshimet, kryesisht furnizimet me zhavor.

2.2 Në kategorinë e shpenzimeve komunale :

Shërbimet e shëndetësisë primare (74050), shuma prej 3,374.57 €.

- **Arsyetim:** Bartje e obligimeve të pashlyera për shkak të rritjes së çmimit tek shpenzimet komunale.

2.3 Në kategorinë e shpenzimeve kapitale:

Planifikimi urban dhe inspeksion (66395), në projektet:

- “Asfaltimi i rrugëve lokale ne Cerovik-Qabiq”, kodi (48153), shuma prej 35,000.00 €;
- “Asfaltimi i rrugëve lokale Gjurgjevik i Vogel- Klinave”, kodi (47221), shuma prej 10,000.00 €;
- “Asfaltimi i rrugëve lokale ne Gremnik”, kodi (47171), shuma prej 15,000.00 €;
- “Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Jashanicë-Jelloç-Resnik-Pogragjë”, kodi (49602), shuma prej 57,500.00 €;

“Asfaltimi i rrugëve Ujemir-Shtaricë-Siqevë”, kodi (50664), shuma prej 35,000.00 €;
“Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Volljakë-Sferkë-Qupevë”, kodi (50666), shuma prej 37,500.00 €;
“Ndërtimi me gurë i sheshit dhe rrugëve në qytet”, kodi (48262), shuma prej 69,000.00 €;
“Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Kryshevë e Vogël”, kodi (50667), shuma prej 30,000.00 €;
“Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Qeskovë”, kodi (51445), shuma prej 7,820.00 €.

2.4 Infrastruktura Rrugore (18018), në projektet:

“Sanimi i gropave të rrugëve me asfalt në Resnik, Leskoc etj.”, kodi (52516), shuma prej 40,000.00 €;

- **Arsyetim:** Në vitin 2022 dhe në vijim inflacioni global e ka rritur edhe koston e shpenzimeve. Për këtë arsye në vitin 2022 kemi kontrata që nuk janë realizuar sipas planifikimit buxhetor dhe kanë mbetur të kryhen në këtë vit si dhe disa projekte për shkak të inflacionit nuk kemi arritur t'i kontraktojmë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa Ekonomi dhe Zhvillim.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

5. Me këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e FEZH, Zyra për Informim dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 601-21739 /2023
Klinë, më 03.07 /2023



Kryesuesi,
Fadil Gashi